



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

**Shtojca 11**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1**

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT )**

[23.10.2023]

Drejtuar: Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “E M K O” SH.P.K & “ASLV” SH.P.K, perfaqesuar nga operatori ekonomik “E M K O” SH.P.K, me adrese “Fshati Lalm, Pasuria Nr.102/26, Zona Kadastrale 2376, Vaqarr, Tirane

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur /Mallra

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-78810-08-31-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “F+V materiale dhe pajisje per arredimin, ndriçimin skenik dhe fonise se Pallatit te Kultures”

Kohëzgjatja e kontratës: 60 dite nga data e nenshkrimit te kontrates

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “E M K O” SH.P.K, me Nuis K61424016V & “ASLV” SH.P.K me Nuis L31329009M dhe me oferte ekonomike 23,997,674 (njëzet e tre milion e nëntëqind e nentëdhjetë e shtate mije e gjashtëqind e shtatëdhjetë e kater) lek pa TVSH
- 2- Operatori Ekonomik “M. LEZHA”, me Nuis J76504013C dhe pa oferte ekonomike
- 3- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, me Nuis J87603505T dhe me oferte ekonomike 23,987,150 (njëzet e tre milion e nenteqind e tetëdhjetë e shtate mije e njëqind e pesëdhjetë) lek pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**I- Operatori Ekonomik “M. LEZHA”, me Nuis J76504013C.**

<sup>1</sup> Ky Formular eshte i aplikueshem nese ka Ankime

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 2.2.1, 2.2.2 dhe 2.3.1, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne lidhje me xhiron , bilancet dhe furnizime te ngjashme.

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 dhe 2.3.8, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion ne lidhje autorizim prodhuesi, katalog/fragment katalogu, oferte teknike dhe iso.

**Se treti**, nuk ploteson kriterin 2.3.9, ku parashikohet se “Ditën dhe oren e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

<b>I. Blerje pajisje per arredim</b>	
<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>
<b>1</b>	<b>Post (Ulese) per sallën e Pallatit te Kultures</b>
<b>2</b>	<b>Karrige fikse</b>
<b>II. Blerje pajisje ndriçimi</b>	
<b>1</b>	<b>Ndrçues LED 100W, me Optike te ndryshueshme 25° - 50°, me konektor 5p + PowerCON, IP20, 5,8 kg, 3000K, I zi</b>
<b>III. Blerje pajisje fonie</b>	
<b>1</b>	<b>Altopolant 2 rrugesh, 15 °, 500/1000W AES, 138db SPL</b>
<b>2</b>	<b>Amplifikator Audio I klasit “I”</b>

- *Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë magazines ne administrim te Drejtorise se Sherbimeve Publike, te Bashkise Lezhe me adrese: Rruga “Vellezerit Coku”, Ish SMT, Lezhe.*
- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.*
- *Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.*

pasi Bazuar ne procesverbalin Nr. 01, date 18/09/2023, i mbajtur midis Komisionit te Vleresimit te ofertave dhe Operatoreve Ekonomik qe jane paraqitur per te dorezuar mostrat ditën dhe oren e hapjes se ofertave, rezultoi se ky OE nuk eshte paraqitur per te dorezuar mostrat.

Sa me siper duke qene se operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje nga mostart e kekruara moster per ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për

të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “M. LEZHA”, me Nuis J76504013C, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “M. LEZHA”, me Nuis J76504013C, skualifikohet.**

## **II- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, me Nuis J87603505T**

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 2.3.6 të DST-se ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalog/ fragment katalogu të prodhuesit për mallrat sipas tabelës së mëposhteme, ku të pasqyrohen të gjithë specifikimet teknike të produktit:*

<b><i>I. Blerje pajisje per arredim</i></b>	
<b><i>Nr.</i></b>	<b><i>Emertimi</i></b>
<i>1</i>	<i>Post (Ulese) per sallen e Pallatit te Kultures</i>
<i>2</i>	<i>Karrige</i>
<b><i>II. Blerje pajisje ndriçimi</i></b>	
<i>1</i>	<i>Ndrciues LED 12x8W RGBW/FC</i>
<i>2</i>	<i>Ndrciues rrobotik me llampe 132W, 3.5 °, Me prizem 8f</i>
<i>3</i>	<i>Njesi profesionale kontrolli DMX 1</i>
<b><i>III. Blerje pajisje fonie</i></b>	
<i>1</i>	<i>Altopolant 2 rruges, 15 °, 500/1000W AES, 138db SPL</i>
<i>2</i>	<i>Amplifikator Audio I klasit “I”</i>
<i>3</i>	<i>Mixer Audio me 18 kanaledhe USB Audio Interface</i>

KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin katalog/fragment katalogu të prodhuesit ne gjuhen shqipe për mallrat e kerkuara ne piken 2.3.6 te DST-se.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur katalog/fragment ne gjuhe te huaj dhe te paperkthyer ne gjuhen shqipe për pajisjet e ndricimit dhe fonise.

KVO veren se ne piken 2 te nenit 24 te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

*2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.*

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021, mban te njejtin qendrim ne te cilin theksohet se: **“II.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion”.**

Sa me siper duke qene se OE nuk ka paraqitur katalog/fragment katalogu te paperkthyer ne gjuhen shqipe, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.9, ku parashikohet se: *“Ditën dhe oren e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:*

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

<b>I. Blerje pajisje per arredim</b>	
<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>
<b>1</b>	<b>Post (Ulese) per sallën e Pallatit te Kultures</b>
<b>2</b>	<b>Karrige fikse</b>
<b>II. Blerje pajisje ndriçimi</b>	
<b>1</b>	<b>Ndrçiuës LED 100W, me Optike te ndryshueshme 25° - 50°, me konektor 5p + PowerCON, IP20, 5,8 kg, 3000K, 1 zi</b>
<b>III. Blerje pajisje fonie</b>	
<b>1</b>	<b>Altopolant 2 rruges, 15 °, 500/1000W AES, 138db SPL</b>
<b>2</b>	<b>Amplifikator Audio I klasit “I”</b>

- *Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë magazines ne administrim te Drejtorise se Sherbimeve Publike, te Bashkise Lezhe me adrese: Rruga “Vellezerit Coku”, Ish SMT, Lezhe.*

- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.*
- *Mostrat duhet të jene ne përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.*

pasi Bazuar ne procesverbalin Nr. 03, date 18/09/2023, i mbajtur midis Komisionit të Vleresimit të ofertave dhe Operatorit Ekonomik “STELLA” SH.P.K, gjate zhvillimit të procedurës për dorezimin e mostrave ditën dhe oren e hapjes së ofertave, rezultoi se nuk është paraqitur një nga mostrat si me poshte:

Nr.	Emertimi mallit	Sasia	Shenime
<b>1</b>	<b>Post (Ulese) per sallën e Pallatit të Kultures</b>	<b>0</b>	<b>Nuk paraqiti mostër</b>
2	Karrige fikse	1	Ska
3	Ndrciues LED 100W, me Optike të ndryshueshme 25° - 50°, me konektor 5p + PowerCON, IP20, 5,8 kg, 3000K, I zi	1	Ska
4	Altopolant 2 rruges, 15 °, 500/1000W AES, 138db SPL	1	Ska
5	Amplifikator Audio I klasit “I”	1	Ska

Sa me lart duke qene se operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostër për **“Post (Ulese) per sallën e Pallatit të Kultures”**, i cili është produkti që ze vlerën me të lartë të preventivit ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat

dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “STELLA” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

**Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “STELLA” SH.P.K, me Nuis J87603505T, skualifikohet.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “E M K O” SH.P.K & “ASLV” SH.P.K, përfaqësuar nga operatori ekonomik “E M K O” SH.P.K, me adresë “Fshati Lalm, Pasuria Nr.102/26, Zona Kadastrale 2376, Vaqarr, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë të përgjithshme prej 23,997,674 (njëzet e tre milion e nëntëqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lek pa TVSH është identifikuar si oferta e sukseshme

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Lezhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**